



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.114/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, përkitazi me ankesën e Abaz Ademi kandidat për deputet nga rradhet e subjektit politik BSDAK (Bosnjačka Stranka Demokratska Akcija Kosova), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në lidhje me parregullsi të numerimit të votave të hasura përgjate shpalljes së rezultateve përfundimtare, në seancën e mbajtur më 02.02.2011, mori:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Abaz Ademit kandidat për deputet nga rradhet e subjektit politik BSDAK

ARSYETIMI

Me datën 31.01.2011 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Abaz Ademi, bartësi i listës së BSDAK-së, me të cilën parashtron ankesë lidhur me raportin e publikuar nga KQZ-ja të datës 31.01.2011, në të cilin thuhet që “*më së shumti vota ka pasur Hamze Balje me nr.7*”. Parashtruesi i ankesës kërkon “*që të behet rinumërimi i votave sepse për numrin 1 dhe numrin 25 kanë votuar qytetarët e Mitrovicës. Në këtë votim sipas parashtruesit të ankesës ka qenë involvuar edhe një subjekt tjetër politik BK se bashku me aktivistët e tij të cilët kanë votuar për këta numrat e cekur më lartë dhe ata do të dëshmojnë personalisht për këtë gjë*”. Më tutje në ankesë kërkohet “*që të zhvillohet hetimi se cili kandidat i partisë BSDAK ka pasur më së shumti vota dhe që të verifikohet mandati pas hetimit të hollësishëm nga institucionet përkatëse dhe kompetente dhe që të dilet me dëshmitë*”. Parashtruesi i ankesës si dëshmitar përmend Sami Maliqin, i cili thekson se sebashku me aktivistët e tij kanë votuar për BSDAK – nr.1 dhe nr.25.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

Për të vërtetuar faktin e pretenduar nga parashtruesi i ankesës PZAP i beri një kërkesë KQZ-së me datë 31.01.2011, për sqarimin e pasqyrimin jo real të rezultateve përfundimtare, dhe KQZ iu përgjigj kësaj kërkesës për sqarim me datë 01.02.2011, duke njoftuar se *“procesin e votimit dhe përpilimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 2010/2011 e ka përshkruar një proces i gjatë dhe gjithëpërfshirës i kontrollimit, auditivit dhe verifikimit të saktësisë së të dhënave dhe rezultateve. Për shkak të mospërputhjeve të konstatuara numrit të fletëvotimeve të hedhura në kutin e votimit dhe numrit të votuesve në listen përfundimtare të votuesve (LPV) mbi nivelin plus/minus 6 dhe parregullsive tjera, 760 vendvotime i janë nënshtruar i janë nënshtruar procesit të rinumërimit të votave të zgjedhjeve 12 dhjetor 2010, 92 vendvotime në zgjedhjet e 09 janarit 2011 dhe 38 vendvotime në zgjedhjet e 23 janarit 2010. Në rezultatet përfundimtare të QNR-së të shpallura nga KQZ-ja me 30 janar 2011 është përfshirë edhe numri i votave me kusht, votave të votimit përmes postës dhe atyre me nevoja të veçanta. Procesi i rinumërimit të votave në këto VV ka qenë transparent dhe është zhvilluar në praninë e vëguesve të subjekteve politike të certifikuara, medieve, faktorit ndërkombëtar si dhe në bashkëpunim me këshilltarët e IFES-it. Mbi bazën e gjithë këtij procesi janë prodhuar rezultatet e QNR-së të shpallura nga KQZ me 30 janar 2011”*.

PZAP shqyrtoi Listat e VV të rinumëruara sipas vendimeve përkatëse të KQZ-së dhe Master Lista me QV për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2010 dhe erdhi në përfundim se parregullsitë e pretenduara janë eliminuar gjatë rinumërimit dhe auditimit nga KQZ-ja. Si rrjedhim PZAP konstatoj se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë korrigjuar dhe pere kete arsye e refuzoi ankesën si të pabazuar. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 114/2011 më datën 02.02.2011.

Kryesuesi i Panelit

Muhamet Rexha

